



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dorezuar Priljeft/Prodato Received/Delivery	25-05-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHUK	4477/2023		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.660/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.660/2023 të datës 24.04.2023 të parashtruar nga ankuesja , me adresë rruga , në Ferizaj, kundër organit të punësimit/ Komunës së Ferizajit, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 25.05.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

*Hedhet poshtë si e palejuar* ankesa me numër A.nr.660/2023 e datës 24.04.2023 e parashtruar nga ankuesja

### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar sipas Ndryshimi dhe Plotësimi të Aktit të Emërimit të datës 01.02.2019 në pozitën *Udhëheqës për Komunikim me Publikun* në Komunën e Ferizajit, më datë 02.03.2023 ka parashtruar kërkesë tek Menaxheri i Personelit i Komunës së Ferizajit përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e të ardhurat personale sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 01.02.2019. Udhëheqësja e Personelit më datë 30.03.2023 përmes përgjigjes në kërkesë me Nr.0 01-52/23 ka njoftuar ankuesen që në mungesë të mjeteve buxhetore nuk është realizuar kërkesë në regjistrin e pagave sipas koeficientit të përcaktuar në akt emërim.

Ankuesja ndaj kësaj përgjigje më datë 24.04.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3734/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kërkuar që

të obligohet Komuna e Ferizajit të bëjë kompensimin në mënyrë retroaktive nga data 01.02.2019 deri në nxjerrjen e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 05.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Ferizajit. Ndërsa Këshilli më datë 11.05.2023 ka përcjell shkresat ndërlidhur më çështjen në procedurë të shqyrtimit.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 3734/2023 të datës 24.04.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ndryshimi dhe Plotësimi të Aktit të Emërimit të datës 01.02.2019; Përgjigje në kërkesë me Nr. 01-52/23 e datës 30.03.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.05.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 11.05.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për Udhëheqës të Sektorit të Komunikimit me Publikun të datës 01.02.2019; Kërkesën e ankuese e datës 02.03.2023; Formularin i të dhënave në listën e pagave datës 01.10.2020, 08.08.2022; Listën e pagave shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor 2019; Listën e pagave janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor 2020; Listën e pagave janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor 2021; Listën e pagave janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor 2022; Listën e pagave janar, shkurt, mars, prill 2023.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që t'i njihet e drejta e kompensim kompensimin në mënyrë retroaktive nga data 01.02.2019 në diferencën nga koeficienti shtatë (7) në koeficientin nëntë (9) dhe deri në nxjerrjen e këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit shqyrtoj pretendimin ankimor të ankueses lidhur me kompensimin në mënyrë retroaktive të diferencës së koeficienteve, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankueses si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesja nga data 01.02.2019 është caktuar në pozitën e punës *Udhëheqës për Komunikim me Publikun*, ku ka realizuar koeficient shtatë (7) të pagës dhe se e njëjta përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 02.03.2021 (*data e parashtrimit të kërkesës tek Menaxheri i Personelit*), rrjedhimisht ankuesja nuk e kishte kundërshtuar Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit të datës 01.02.2019 në kuptim të koeficientit të pagës, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (*ligj i aplikueshëm në kohën e lëshimit dhe nënshkrimit të Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 01.02.2019*), përkatësisht nenin 127 paragrafi 1 të këtij ligji ku përcaktohet se: "*Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ*", andaj, mbi këtë bazë rrjedh së ankesa e ankueses është palejueshme.



Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda,A.nr.660/2023,datë 25/05/2023

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses,
- Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Ferizajt; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;